20262524588

АГЕНЦИЈА ЗА УПРАВУВАЊЕ СО ОДЗЕМЕН ИМОТ

Në bazë të nenit 16 paragrafi 1 alinea 6 të Ligjit për menaxhimin e pasurisë së konfiskuar, dobisë pasurore dhe sendemeve të konfiskuara (*) („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr.64/24, 37/25, 86/25, 101/25, 135/25, 132/26 dhe 212/26) dhe në pajtim me nenin 15 paragrafi 1 alinea 6 të Statutit të Agjensionit për menaxhimin e pasurisë së konfiskuar nr.02-4368/2 të datës 02.12.2024, Këshilli Drejtues i Agjensionit për menaxhimin e pasurisë së konfiskuar në seancën e 13-të me radhë për vitin 2026 të mbajtur më datë 22.10.2026, solli këtë

RR E G U LL O R E
PËR DHËNIEN NË SHFRYZËZIM TË SENDEVE TË SEKUESTRUARA DHE TË KONFISKUARA PËRKOHËSISHT — MJETEVE MOTORIKE ME TË CILAT MENAXHON AGJENSIONI PËR MENAXHIMIN E PASURISË SË KONFISKUAR

1. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Me këtë Rregullorë rregullohet dhënia në shfrytëzim e sendit(-eve) të sekuestruar(-a) përkohësisht - mjetit/ve motorik/e dhe/ose sendit(-eve) të konfiskuar(-a) përfundimisht - mjetit/ve motorik/e me të cilat menaxhon Agjensioni për menaxhimin e pasurisë së konfiskuar (në tekstin e mëtejmë: Agjensioni), organet shtetërore, fondet, agjencitë, drejtoritë, institucionet publike dhe ndërmarrjet publike, organet e pavarura rregullatore të themeluara nga shteti, shoqëritë tregtare në pronësi të plotë shtetërore dhe institucionet e tjera të themeluara nga shteti, njësitë e vetëqeverisjes lokale, si dhe shoqatat dhe fondacionet, me pëlqim paraprak nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

2. KLASIFIKIMI DHE KARAKTERISTIKAT

Neni 2

Shprehjet e veçanta të përdorura në këtë rregullorë kanë këtë klasifikim dhe karakteristika:

A) MJET MOTORIK PËR UDHËTARË: është çdo mjet me motor, i cili zakonisht përdoret për transportin e personave dhe mallrave në rrugë ose për tërheqjen e mjeteve në rrugë, i cili ka së paku katër rrota dhe shpejtësi maksimale të projektuar mbi 25 km/h dhe përveç ulëses së shoferit ka më së shumti tetë ulëse.

1. Klasa e ulët e mjetit: përfshin mjetet motorike për udhëtarë (automjetet e vogla të qytetit dhe minikombët), me vëllim të vogël të motorit, konsum të ulët të karburantit, madhësia dhe/ose gjatësia e të cilave është më e vogël se mjetet në klasat e tjera dhe çmimi është më i përballueshëm.

2. Klasa e ulët e mesme kompakte: përfshin mjetet motorike për udhëtarë të cilat për nga madhësia janë më të mëdha se automjetet e vogla të qytetit, kurse më të vogla se ato që janë në klasën e mesme.

---

[1] Nën mjete motorike në këtë rregullorë nënkuptohen “mjetet me motor” në pajtim me Ligjin për automjete („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr.140/08, 53/11, 123/12, 153/12, 70/13, 164/13, 138/14, 154/15, 192/15, 39/16 dhe „Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr.161/19, 87/23, 148/25, 160/25, 258/25, 58/26 dhe 145/26).

3. Klasa e mesme: përfshin mjete me madhësi më të madhe se klasa kompakte, kurse më të vogël se klasa e mesme e lartë.

4. Klasa e mesme e lartë: përfshin mjetet më të mëdha se klasa e mesme, kurse më të vogla se ajo e lartë. Kjo klasë quhet edhe klasa e biznesit.

5. Klasa e lartë: përfshin automobile, madhësia dhe luksi i të cilave tejkalojnë të gjitha klasat e tjera.

6. Autobusi: mjet motorik i destinuar për transportin e personave me më shumë se nëntë ulëse, duke përfshirë edhe ulësen e shoferit.

B) TRAKTORËT DHE MEKANIZMI BUJQËSOR: përfshin mjet motorik, të konstruktuar për kryerjen e punëve bujqësore ose pyjore, me fuqi tërheqëse, me ose pa rimorkio, duke përfshirë traktorin bujqësor ose pyjor me rrota ose me zvarritës me motor të vetin, të konstruktuar posaçërisht për tërheqje, shtypje, mbajtje dhe për t'i dhënë fuqi pajisjes së caktuar shtesë e cila është e konstruktuar për kryerjen e punëve bujqësore ose pyjore, respektivisht për tërheqjen e rimorkiove bujqësore ose pyjore, dhe mund të jetë i përshtatur për transportin e ngarkesës në kuadër të punëve bujqësore dhe pyjore.

C) MJETET TËRHEQËSE TË NGARKESËS DHE MEKANIZMI NDËRTIMOR është çdo mjet me motor, i cili zakonisht përdoret për transportin e ngarkesës dhe përfshin mjetet motorike të destinuara për punë me mekanizëm ndërtimor dhe mekanizëm ndërtimor.

3. DHËNIA NË SHFRYTËZIM TË SENDEVE TË SEKUESTRUARA DHE TË KONFISKUARA PËRKOHËSISHT – MJETEVE MOTORIKE

Neni 3

Agjensioni do t'i jep në shfrytëzim sendin(-et) e sekuestruar(-a) përkohësisht - mjetit/ve motorik/e dhe/ose sendit(-eve) të konfiskuar(-a) përfundimisht - mjetit/ve motorik/e, në bazë të kërkesës së dorëzuar nga institucionet e numëruara në nenin 1 të kësaj Rregulloreje, në pajtim me karakteristikat dhe nevojat e paraqitura në kërkesën për dhënie në shfrytëzim të sendit(-eve) të sekuestruar(-a) përkohësisht - mjetit/ve motorik/e dhe/ose sendit(-eve) të konfiskuar(-a) përfundimisht - mjetit/ve motorik/e.

Kërkesa drejtuar Agjensionit do të dorëzohet në formularin e parashikuar, i cili është pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje. Kërkesa nga paragrafi 2 i këtij neni dorëzohet si:

1. Kërkesë për dhënie në shfrytëzim të sendit(-eve) të sekuestruar(-a) përkohësisht - mjetit/ve motorik/e, me shtojcë ndaj kërkesës - Deklaratë - Formulari numër 1; dhe

2. Kërkesë për dhënie në shfrytëzim të sendit(-eve) të konfiskuar(-a) përfundimisht - mjetit/ve motorik/e, me shtojcë ndaj kërkesës - Deklaratë - Formulari numër 2.

Kërkesa e plotësuar dorëzohet në arkivin e Agjensionit ose në rrugë elektronike.

Agjensioni vepron vetëm sipas kërkesës plotësisht dhe saktësisht të plotësuar për dhënie në shfrytëzim të sendit(-eve) të sekuestruar(-a) përkohësisht - mjetit/ve motorik/e ose sendit(-eve) të konfiskuar(-a) përfundimisht - mjetit/ve motorik/e.

4. VEPRIMI GJATË DHËNIES NË SHFRYTËZIM TË SENDEVE TË SEKUESTRUARA DHE TË KONFISKUARA PËRKOHËSISHT – MJETEVE MOTORIKE

Neni 4

Gjatë dhënies në shfrytëzim të sendit(-eve) të sekuestruar(-a) përkohësisht - mjetit/ve motorik/e dhe/ose sendit(-eve) të konfiskuar(-a) përfundimisht - mjetit/ve motorik/e institucioneve të numëruara në nenin 1 të kësaj Rregulloreje, Agjensioni do t'i ketë parasysh kërkesat e mbërritura dhe llojin e disponueshëm të mjetit/ve motorik/e me të cilin disponon

Agjensioni, në bazë të të cilit do të vendoset lidhur me kërkesën e dorëzuar për dhënie në shfrytëzim të mjeteve motorike dhe do të sillet vendim nga ana e Këshillit Drejtues të Agjensionit për të cilin pëlqim duhet të japë Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

5. SHPËRNDARJA E SENDEVE TË SEKUESTRUARA DHE TË KONFISKUARA PËRKOHËSISHT – MJETEVE MOTORIKE SIPAS KLASIFIKIMIT, KARAKTERISTIKAVE DHE INSTITUCIONEVE

Neni 5

Gjatë shpërndarjes së automjeteve sipas klasifikimit, karakteristikave dhe në pajtim me kërkesat e institucioneve nga neni 1 i kësaj Rregulloreje, Agjensioni i merr parasysh klasën e mjetit motorik dhe vlerësimin, vitin e prodhimit të mjetit motorik, gjendjen e përgjithshme të mjetit motorik të konstatuar me procesverbal (zapisnik), pajisjen e mjetit motorik, gjendjen e jashtme të karroserisë dhe enterierit të brendshëm.

Neni 6

Organeve të administratës shtetërore nga neni 1 i kësaj Rregulloreje Agjensioni do t'u jep në shfrytëzim mjete motorike të klasës së lartë dhe të klasës së mesme të lartë vetëm në rast kur bëhet fjalë për kërkesë për dhënie në shfrytëzim të mjetit motorik për nevojat e funksionarit i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore.

Organeve të administratës shtetërore nga neni 1 i kësaj Rregulloreje Agjensioni do t'u jep në shfrytëzim mjete motorike të klasës së mesme: klasës së ulët të mesme kompakte dhe klasës së ulët vetëm në rast kur bëhet fjalë për kërkesë për dhënie në shfrytëzim të mjetit motorik për nevojat e shërbimeve profesionale të cilat punojnë në organin e administratës shtetërore.

Për nevojat e organeve të pushtetit gjyqësor dhe organeve të tjera gjyqësore, fondeve, agjencive, drejtorive, institucioneve publike dhe ndërmarrjeve publike, trupave të pavarur rregullatorë të themeluara nga shteti, shoqërive tregtare në pronësi të plotë shtetërore dhe institucioneve të tjera të themeluara nga shteti, Agjencia do t'u jep në shfrytëzim mjete motorike të klasës së mesme të lartë vetëm në rast kur bëhet fjalë për kërkesë për dhënie në shfrytëzim të mjetit motorik për nevojat e funksionarit i cili udhëheq me këto institucione.

Për nevojat e fondeve, agjencive, drejtorive, institucioneve publike dhe ndërmarrjeve publike, shoqërive tregtare në pronësi të plotë shtetërore dhe institucioneve të tjera të themeluara nga shteti, Agjencia do t'u jep në shfrytëzim mjete motorike të klasës së mesme, klasës së ulët të mesme kompakte dhe klasës së ulët vetëm në rast kur bëhet fjalë për kërkesë për dhënie në shfrytëzim të mjetit motorik për nevojat e shërbimeve profesionale të cilat punojnë në këto institucione.

Për nevojat e organeve të pushtetit gjyqësor dhe organeve të tjera gjyqësore dhe trupave të pavarur rregullatorë të themeluara nga Republika e Maqedonisë së Veriut, Agjencia do t'u jep në shfrytëzim mjete motorike të klasës së mesme vetëm në rast kur bëhet fjalë për kërkesë për dhënie në shfrytëzim të mjetit motorik për nevojat e shërbimeve profesionale të cilat punojnë në këto organe.

Për nevojat e njësive të vetëqeverisjes lokale në Republikën e Maqedonisë së Veriut Agjencia do t'u jep në shfrytëzim mjete motorike të klasës së mesme të lartë, vetëm në rast kur bëhet fjalë për kërkesë për dhënie në shfrytëzim të mjetit motorik për nevojat e funksionarit i cili udhëheq me këto institucione.

Për nevojat e njësive të vetëqeverisjes lokale në Republikën e Maqedonisë së Veriut, Agjencia do t'u jep në shfrytëzim mjete motorike të klasës kompakte dhe klasës së ulët vetëm në rast kur

bëhet fjalë për kërkesë për dhënie në shfrytëzim të mjetit motorik për nevojat e shërbimeve profesionale të cilat punojnë në këto institucione.

Për nevojat e shoqatave dhe fondacioneve në Republikën e Maqedonisë së Veriut, Agjencia do t'u jep në shfrytëzim mjete motorike të klasës kompakte dhe klasës së ulët vetëm në rast kur bëhet fjalë për kërkesë për dhënie në shfrytëzim të mjetit motorik për nevojat e zbatimit të aktiviteteve të rregullta të shoqatave dhe fondacioneve në fushën e mbrojtjes së grupeve dhe kategorive të qytetarëve në rrezik social, e të cilat janë në kuadër të veprimtarisë së tyre të regjistruar.

Neni 7

Mjetet motorike nga neni 2 i kësaj Rregulloreje, Agjencia do t'ia jep në shfrytëzim institucioneve të numëruara në nenin 1 të kësaj Rregulloreje, në pajtim me karakteristikat dhe nevojat e paraqitura në kërkesën për dhënie në shfrytëzim të sendit(-eve) të sekuestruar(-a) përkohësisht - mjetit/ve motorik/e dhe/ose sendit(-eve) të konfiskuar(-a) përfundimisht - mjetit/ve motorik/e.

Neni 8

Në rast kur Agjensioni nuk mund t'i përgjigjet kërkesës së dorëzuar për dhënie në shfrytëzim të sendit(-eve) të sekuestruar(-a) përkohësisht - mjetit/ve motorik/e dhe/ose sendit(-eve) të konfiskuar(-a) përfundimisht - mjetit/ve motorik/e, në pajtim me karakteristikat e kërkuara, vetëm në pajtim me kërkuesin e mjetit motorik mund të jep në shfrytëzim mjet motorik edhe nga një klasë tjetër e mjeteve motorike të konfiskuara ekzistuese.

6. DORËZIMI-PRANIMI I SENDEVE TË SEKUESTRUARA DHE TË KONFISKUARA PËRKOHËSISHT – MJETEVE MOTORIKE

Neni 9

Agjensioni nuk do të kryejë dorëzim me procesverbal të mjetit motorik të dhënë në shfrytëzim nëse tek institucionet e numëruara në nenin 1 të kësaj Rregulloreje të cilave u është dhënë mjeti motorik, në rastet kur në momentin para se të kryhet dorëzim-pranimi formal i mjetit motorik, nga ana e Agjensionit ose nga ana e institucioneve të cilave u jepet mjeti, konstatohet se mjeti në fjalë për të cilin është sjellë vendim për dhënie në shfrytëzim nuk u përgjigjet karakteristikave teknike të përcaktuara më parë ose ka dëmtime më të mëdha në mjet, me çka shpenzimet për aftësimin e mjetit të dhënë në shfrytëzim janë ekonomikisht të paarsyeshme.

Mjeti do t'i dorëzohet institucionit që e ka dorëzuar kërkesën pasi të jepet pëlqim ndaj vendimit të Këshillit Drejtues të Agjencisë nga ana e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe pasi institucioni të paguajë 7% të vlerës së mjetit motorik të vlerësuar në llogarinë e Agjensionit, në pajtim me Deklaratën të cilën e kanë të nënshkruar dhe është në shtojcë të kërkesës së dorëzuar.

7. DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Neni 10

Kjo rregullorë hyn në fuqi ditën e tetë nga dita e shpalljes në „Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut“.

Pas hyrjes në fuqi, kjo rregullorë do të publikohet edhe në faqen e internetit të Agjensionit.

Neni 11

Me sjelljen e kësaj Rregulloreje, pushojnë së vlefuri Rregullorja me kritere për dhënie në shfrytëzim të sendeve të konfiskuara – mjeteve me të cilat menaxhon Agjencia për Menaxhimin e Pasurisë së Konfiskuar Nr.01-714/1 i datës 7 shkurt 2025, e shpallur në („Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr.50/25), Rregullorja për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores me kritere për dhënie në shfrytëzim të sendeve të konfiskuara – mjeteve me të cilat menaxhon Agjencia për Menaxhimin e Pasurisë së Konfiskuar Nr.01-4695/1 i datës 30 tetor 2025 e shpallur në („Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr.252/25) dhe Rregullorja për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores me kritere për dhënie në shfrytëzim të sendeve të konfiskuara – mjeteve me të cilat menaxhon Agjencia për Menaxhimin e Pasurisë së Konfiskuar nr.01-3460/1 i datës 16 korrik 2026, e shpallur në („Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr.173/26).

Agjencia për Menaxhimin e
Pronës së Konfiskuar
Këshilli Drejtues
Kryetari,
Станко Китаноски, d.v.

Nr. 01-5182/1
22.10.2026
Shkup

1. Образец на барање / 1.Formulari I kërkesës

ДО
Агенцијата за управување со одземен имот
Бул. Киро Глигоров бр.4

Deri te
Agjensioni për menaxhim me pronën e sekuestruar
Bulevardi "Kiro Gligorov" nr. 4

БАРАЊЕ/KËRKESË

за отстапување на привремено одземен(и) предмет(и) моторно/и возило/а/ për dorëzimin e sendit/sendeve të sekuestruara përkohësisht mjet motorik

Од / Nga _____
(назив на барателот / emri I kërkuesit)

Контакт телефон и електронска пошта / numër kontakti dhe adresë elektronike:

_____

Контакт (одговорно) лице / kontakt (personi përgjegjës):

_____

Согласно Законот за управување со конфискуван имот, имотна корист и одземени предмети во кривична и прекршочна постапка (*) („Службен Весник на Република Северна Македонија“ бр. 64/14, 37/25, 86/25, 101/25 135/25 и 132/26), бараме Агенцијата за управување со одземен имот да ни отстапи привремено одземен предмет – моторно возило, за потребите на/ Në bazë të Ligjit për menaxhimin e pasurisë së konfiskuar, dobisë pasurore dhe sendeve të sekuestruara në procedurë penale dhe kundërvajtëse (*) ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 64/14, 37/25, 86/25, 101/25, 135/25 dhe 132/26), kërkojmë nga Agjensioni për menaxhimin e pasurisë së sekuestruar të na jape një send të sekuestruar përkohësisht – mjet motorik, për nevojat e:

- Функционерот кој раководи со институцијата / zyrtarit që menaxhon institucionin
- Стручна служба на институцијата/ shërbimi professional i institucionit

(заокружете го потребното / rrethoni të duhurin)

_____

_____

_____

_____

(да се наведе детален опис на потребното возило/ класа, карактеристики и за која намена / потреба, / jepni një përshkrim te detajuar të automjetit, të kërkuar, klasës, karakteristikave dhe për çfarë qëllimi/ nevoje)

1)Досега Агенцијата за управување со одземен имот ни нема отстапено привремено одземен предмет-моторно возило/ Deri më tani, Agjensioni për menaxhimin e pasurisë së sekuestruar nuk na ka dhënë në shfrytëzim asnjë send të konfiskuar përkohësisht – automjet.

2) Предметниот привремено одземен предмет-моторно возило ни се отстапува _____пат/ Sendi në fjalë i konfiskuar përkohësisht – automjeti na jepet në shfrytëzim për herë të_____.

За потребите на нашата институција, Агенцијата за управување со одземен имот, по добиена согласност од страна на Владата на Република Северна Македонија, има отстапено возила. Për nevojat e institucionit tone, Agjensioni për menaxhim me pronën e sekuestruar, pas marrjes së pëlqimit nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, ka dorëzuar automjetë. _____

Потпис на овластено лице / Датум/ Data
Nënshkrimi i personit të autorizuar

_____ _____

Прилог кон 1. Образец на барање

Shtojca e 1. Formularit të kërkesës

ИЗЈАВА/DEKLARATË

Со оваа изјава како одговорно лице во правното лице _____,се согласувам доколку Владата на Република Северна Македонија даде согласност за отстапување на привремено одземениот предмет-моторно возило, пред неговото преземање да ѝ уплатам на Агенцијата за управување со одземен имот 7% од проценетата вредност.

Me këtë deklaratë si person përgjegjës në personin juridik_____, pajtohem nëse Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut jep miratimin për dorëzimin e sendit të sekuestruar-përkohësisht mjet motorik para marrjes së tij, do t'I paguajë Agjensioni për menaxhim me pronën e sekuestruar 7% të vlerës së vlerësuar.

Доколку биде донесена одлука за враќање на привремено одземениот предмет-моторно возило на претходниот сопственик, се согласувам 93% од проценетата вредност да ги уплатам на сметка на сопственикот.

Nëse merret një vendim për t'ia kthyer sendin e sekuestruar përkohësisht- mjetin motorik pronarit të mëparshëm, unë pranoj të paguaj 93% të vlerës së vlerësuar në llogarinë e pronarit.

Потпис на овластено лице

Nënshkrimi i personit të autorizuar

_____

м.п. v.v

2. Образец на барање / 2.Formulari I kërkesës

ДО
Агенцијата за управување со одземен имот
Бул. Киро Глигоров бр.4

Deri te
Agjensioni për menaxhim me pronën e sekuestruar
Bulevardi "Kiro Gligorov" nr. 4

БАРАЊЕ/KËRKESË

за отстапување на конечно одземен(и) предмет(и) мотоно/и возило/а/ për dorëzimin e sendit/sendeve të sekuestruara plotfuqishëm mjet motorik

Од / Nga _____
(назив на барателот / emri I kërkuesit)

Контакт телефон и електронска пошта / numër kontakti dhe adresë elektronike:

_____
Контакт (одговорно) лице / kontakt(personi përgjegjës):

_____
Согласно Законот за управување со конфискуван имот, имотна корист и одземени предмети во кривична и прекршочна постапка (*) („Службен Весник на Република Северна Македонија“ бр. 64/14, 37/25, 86/25, 101/25 135/25 и 132/26), бараме Агенцијата за управување со одземен имот да ни отстапи конечно одземен предмет – моторно возило, за потребите на / Në bazë të Ligjit për menaxhimin e pasurisë së konfiskuar, dobisë pasurore dhe sendeve të sekuestruara në procedurë penale dhe kundërvajtëse (*) („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr. 64/14, 37/25, 86/25, 101/25, 135/25 dhe 132/26), kërkojmë që Agjensioni për menaxhimin e pasurisë së sekuestruar të na japë një send të konfiskuar plotfuqishëm – mjet motorik, për nevojat e:

- Функционерот кој раководи со институцијата / zyrtarit që menaxhon institucionin
- Стручна служба на институцијата/ shërbimit professional të institucionit

(заокружете го потребното / rrethoni të duhurin)

_____

_____

_____

_____

(да се наведе детален опис на потребното возило/ класа, карактеристики и за која намена / потреба / jepni një përshkrim te detajuar të automjetit, të kërkuar, klasës, karakteristikave dhe për çfarë qëllimi/ nevoje)

1)Досега Агенцијата за управување со одземен имот ни нема отстапено конечно одземен предмет-моторно возило/ Deri më tani, Agjensioni për menaxhimin e pasurisë së sekuestruar nuk na ka dhënë në shfrytëzim asnjë send të konfiskuar plotfuqishëm – automjet.

2) Предметниот конечно одземен предмет-моторно возило ни се отстапува _____пат/ Sendi në fjalë i konfiskuar plotfuqishëm – automjeti na jepet në shfrytëzim për herë të_____.

За потребите на нашата институција, Агенцијата за управување со одземен имот, по добиена согласност од страна на Владата на Република Северна Македонија, има отстапено возила. Për nevojat e institucionit tone, Agjensioni për menaxhim me pronën e sekuestruar, pas marrjes së pëlqimit nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, ka dorëzuar automjetë _____.

Потпис на овластено лице /
Nënshkrimi i personit të autorizuar

_____

Датум/ Data

_____

Прилог кон 2. Образец на барање
Shtojca e 2. Formularit të kërkesës

ИЗЈАВА/DEKLARATË

Со оваа изјава како одговорно лице во правното лице _____се согласувам доколку Владата на Република Северна Македонија даде согласност за отстапување на конечно одземениот предмет-моторно возило, пред неговото преземање да ѝ уплатам на Агенцијата за управување со одземен имот 7% од проценетата вредност.

Me këtë deklaratë si person përgjegjës në personin juridik_____, pajtohem nëse Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut jep miratimin për dorëzimin e sendit te konfiskuar –mjet motoric me vendim të formës së prerë, para marrjes së tij, të I paguajë Agjensionit për menaxhim me pronën e sekuestruar 7% të vlerës së parashikuar.

Потпис на овластено лице
Nënshkrimi i personit të autorizuar

_____

м.п. v.v